



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers.

Inspektorati i Punës / Inspektorata Rada / Labour Inspectorate

01 Nr.08-276/2021B

Inspektori i Punës në MFPT- të Inspektoratit të Punës në Kosovë-Prishtinë, Agron Llolluni ID-1801, bazuar në dispozitën e nenit 94 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, të nenit 24 të Ligjit Nr.04/L-161 për Siguri dhe Shëndetin në Punë, Rregullores Nr.05/2014 MPMS për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në përdorimin e pajisjeve të punës në vendet e punës, Rregullores Nr.04/2014 MPMS për kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës, nenit 1, 2 dhe 5 të Ligjit Nr. 2002/9 dhe 03/L-017 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, UA Nr.07/2012 (MPMS), Raportit Zyrtar Nr.01/08-00/2019, më datën 25.05.2022, nxjerrin këtë:

VENDIM

(Për shqiptimin e masës ndëshkimore)

Me rastin e inspektimit në bazë të ankesë së ngritur nga Znj. [REDAKTUAR], ndaj Byroja Kosovare e Sigurimit (në tekstin në vijim: Punëdhënësi).

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Inspektorat të Punës, Nr. 996/2020, ka parashtruar ankesë në Inspektoratin e Punës, për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës.

Në ankesë, ankuesi ka cekur se në BKS ka qenë i punësuar në pozitën e Zyrtares e Kontabilitetit.

Me datë 01.12.2020, ankuesi është njoftuar me njoftim për mos vazhdimin e kontratës së punës, respektivisht ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

Në ankesë, ankuesi thekson se në BKS ka qenë e punësuar në pozitën e Referentes Administrative.

Bazuar në Kontratën e Punës nr 4608/19 kohë zgjatja e kontratës së punës deri me datë 31.12.2020.

Mirëpo sipas ankuesit me datë 01.12.2020 me njoftimin nr. prot. 1125/20 i është ndërprerë marrëdhënia e punës, pas skadimit të afatit të kontratës.

Lidhur me këtë njoftim, ankuesja ka atakuar këtë njoftim me datë 08.12.2020, duke e konsideruar këtë njoftim si të pa ligjshëm, për shkak se ankuesja gjendet në pushim të lehonisë dhe ky veprim i është në kundërshtim të dispozitës së nenit 53 të Ligjit të Punës.

Ankuesja, thekson se ka punuar një periudhë ë gjatë kohore, dhe se ndërprerja e kontratës së punës është në kundërshtim të nenit 10. Paragrafi 5. Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se tri (3) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.

Po ashtu, me shikëputjen e marrëdhënies së punës ka shkelur nenin 40 të Marrëveshjes Kolektive së përgjithshme kolektive të Punës, pasi që shprehimisht ndalohet shikëputja e kontratës së punës gjatë periudhës së lehonisë.

Me datë 21.05.2021 IP ka nxjerre raporti zyrtar 01/08-276/2021 dhe Vendimi me Nr. 01/08-10/2021A.

Lidhur me këtë vendim BKS ka parashtrua ankesë në shkallën e dytë të Inspektorati të punës lidhur me vendimin 01/08-276/2021A.

Inspektorati i Punës, shkalla e dytë me vendimin IP- 141/2022 të datës 14.03.2022 ka nxjerrë vendimin me të cilinë ka refuzuar ankesën e BKS si të pa bazuar dhe ka miratuar vendimin 01/08-276/2021A.

Sipas detyrës zyrtare Inspektori i Punës ka kryer edhe inspektimin ka shqyrtuar ankesën e palës ankuese, gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar janë konstatuar këto parregullsi:

- Për cenimin e dispozitës së Ligjit të Punës 03/L-212 neni 53 lidhur me dispozitën e nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr.07/2012 për Përcaktimin e Gjobave dhe Shumave Konkrete për Shkelje të Dispozitave të Ligjit të Punës, shqiptohet gjoba në lartësi **2,000.00 (dy mijë euro)**.

MASA NDËSHKIMORE

GJITHSEJ GJOBA E SHQIPTUAR 2,000,00€ (dy mijë euro)

Obligohet personi juridik që në afat prej tetë ditësh nga pranimi i këtij Vendimi, gjobën e shqiptuar t'a paguaj në llogarinë bankare 1000430070006532 BQK duke u thirrur në numrin e këtij Vendimi. Dëftesa për kryerjen e pagesës merret në zyre të inspektoratit Rruga "Fehmi Agani".Nr 72 Prishtinë.

Kopja e pagesës, në afat prej 3 (tre) ditësh në vijim, duhet t'i prezantohet Inspektorëve të Punës ose të dërgohet në adresë: Rr. "Fehmi Agani" – nr.72 në Prishtinë, në të kundërtën do të iniciohet procedura përmbarimore.

A r s y e t i m

Pala ankuese, ka parashtruar ankesë në Inspektoratin e Punës, për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës .

Inspektori i punës lidhur me shqyrtimin e ankesës, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave ka konstatuar këtë gjendje faktike:

BKS- është themeluar me datë 01.01.2012 sipas Ligjit të 04/L-018 për Sigurinë e Detyrueshme nga Auto përgjegjësia, në bazë të nenit 29, paragrafi 1 në të cilën dispozitë është përcaktuar : Byroja Kosovare e Sigurimit është organizatë profesionale me cilësinë e personit juridik e themeluar për qëllime jofitimprurëse. Qeveria e Republikës së Kosovës i njeh këtij institucioni statusin e Byrosë nacionale të sigurimit me të drejta të pakufizuara në cilësi të Byrosë pagesë dhe Byrosë trajtuese, që garanton përmbushjen e të gjitha detyrimeve nga sistemi i kartonit ndërkombëtarë të sigurimit.

Në bazë të kontratës së punës është konstatuar se ankuesi ka qenë në marrëdhënie të punës me BKS, bazuar në kontratën e prezantuar me Nr. 1617/19 të datës 24.12.2019 është konstatuar se marrëdhënia e punës është në kohë të caktuar deri me datë 31.12.2020, i cili afat është cekur në neni 2 të kësaj kontrate, kontrata është në harmoni me dispozitë e Ligjit të Punës 03/L-212 neni 11 Përmbajtja e Kontratës së Punës, paragrafi 1. Kontrata e Punës përmban, nën paragrafi 1.6. datën e fillimit të punës dhe 1.7. kohëzgjatjen e Kontratës së Punës, si dhe ankuesja ka qenë e deklaruar në ATK si punonjëse e BKS, i cili verim është në harmoni me Ligjin e Punës 03/L-212 neni 7 4. Për pagesën e kontributeve dhe detyrimeve tjera ligjore, punëdhënësi është i detyruar që të punësuarin t'a lajmërojë në Administratën Tatimore të Kosovës, institucionet e tjera të cilat i menaxhojnë dhe administrojnë skemat e obligueshme pensionale dhe skemat e tjera të obligueshme.

Sa i për këtë pretendimit të ankueses, se punëdhënësi ka vepruar në kundërshtim të dispozitës së Ligjit të Punës 03/L-212 neni 53, ky pretendim i ankuese qëndron. Në bazë të vendimit për Shfrytëzimin e Pushimit të lehonisë Nr. 523/20 të datës 29.06.2020, është konstatuar se ankuesja ka qenë në pushim të lehonisë nga data 29.05.2020 deri me datë 28.05.2021, i cili vendim është në harmoni me dispozitën e Ligjit të Punës 03/L-212 Neni 49 Pushimi i lehonisë, paragrafi 1. Femra e punësuar gëzon të drejtën prej dymbëdhjetë (12) muajve, të pushimit të lehonisë. Në bazë të Fletë lëshimit nga spitali me nr. L 90205497 dhe fletë Flete lëshimin Nr. 5958, është konstatuar se ankuesja ka lindur me datë 29.05.2020.

Andaj, Njoftimi i punëdhënësit për mos vazhdimin e kontratës së punës, është në kundërshtim me dispozitën e Ligjit të Punës 03/L-212 Neni 53 Ndalimi i shkëputjes së kontratës Gjatë kohës së shtatzënisë, pushimit të lehonisë dhe mungesës në punë për shkak të përkujdesjes së veçantë ndaj fëmijës, punëdhënësi nuk mund t'ia shkëpusë kontratën të punësuarit dhe t'ia ndërrojë vendin e punës, përveç në rastet e shkëputjes së kontratës sipas nenit 76 të këtij ligji.

Në shqyrtim të bazës ligjore u konstatua se Ligjvënësi me rastin trajtimit të çështjes së shtatzënisë, pushimit të lehonisë dhe përkujdesjes së veçante ndaj fëmiut ka paraparë ndalesën e shkëputjes, ndërprerjes së marrëdhënies së punës dhe si rast të vetëm të cilin ka lejuar ndërrim të vendit të punës apo shkëputjen e marrëdhënies së punës së punonjëses shtatzënë ose lehonë është plotësimi i kushtit të nenit 76 të po të njëjtit Ligj.

Është konstatuar se në këtë akt juridik/Njoftim nuk është cekur udhëzimi juridik, ky pretendim qëndron, dhe ky veprim i punëdhënësi është në kundërshtim të dispozitës së Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative 05/L -031 Neni 13 Parimi i të drejtës në mjete juridike Përveç kur përjashtohet shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë apo një interes juridik.

Sa i përket pretendimeve të punëdhënësit duke u thirrë në aktgjykimin C.nr 189/17 dhe vërtetimit të aktgjykimit Ac.nr 4074/17, i sqarohet palëve se Inspektori i Punës nuk ka kompetencë e Gjykatave të cekura, gjithashtu aktgjykimet e gjykatave kanë efekt vetëm për lëndën e cila është shqyrtuar nga e asaj gjykate, lidhur me rrethanat në bazë të cilave është ngritur arsyeja e shqyrtimit lëndës nga ana e gjykatës, pra aktgjykimi krijon efekte juridike vetëm për lëndën e shqyrtuar dhe palët në procedurë, ndërsa Ligji i Punës në këtë rast ka efekte juridike ndaj të gjithëve në një marrëdhënie të punës të krijuar në bazë të këtij Ligji.

Më tej aktgjykimet kanë hapësira të veprimit apo krijojnë efekte juridike vetëm atëherë kur ka zbrazëtira juridike.

Pretendimi i ankuesit se kontrata e punës me kohë të caktuar e cila ripërtërihet për (3) vite, atëherë kontrata do të konsiderohet për periudhë të pa caktuar, ky pretendim i ankuesit nuk qëndron dhe nuk është e bazuar në dispozitën e cekur në ankesë, i sqarohet palës ankuese, se kontrata e punës e cila për 10 vite vazhdohet/ripërtërihet, atëherë mundë të konsiderohet si kontratë më periudhë të pa caktuar sipas dispozitës e Ligjit të Punës 03/L-212 neni 10 paragrafi 5 të Ligjit të Punës, Kontrata për një periudhë të caktuar që ripërtërihet në mënyrë të qartë ose të vetëkuptueshme për një periudhë të punësimit më të gjatë se dhjetë (10) vite, konsiderohet si kontratë për një periudhë të pacaktuar kohore.

Në bazë të rrethanave të theksuara më lartë, u vendos si në diapozitiv të këtij Vendimi.

Ky Vendim është përpiluar në katër /4/ ekzemplarë identik. Nga një ekzemplar i dorëzohet palëve në procedurë, ndërsa ekzemplarët tjerë i mbesin Inspektoratit të Punës në Prishtinë për procedurë të mëtutjeshme.

Udhëzim juridik: kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankesë në afat prej 8 ditësh, T E të Inspektoratit të Punës në Kosovë , nëpërmes Inspektorit të Punës në Prishtinë, rruga “ Fehmi Agani “ Nr-72.

Prishtinë ___/___/_____

v.v

Inspektori i Punës

Agron Lllolluni:
